

Tiranë, më 06.06.2019

KONTRATË SHITJE

(Aksionesh në Kapitalin Themeltar)

E lidhur sot, më datë 06.06.2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë), mes palëve kontraktuese si më poshtë:

SHITËS:

Z. RIGERS KASNECI, i biri i Jani-t dhe i Shpresa-s, lindur më 09.02.1981 në Tiranë, dhe banues në Tiranë, madhor e me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i "letërnjoftimi" (ID me Nr. 033505899 / Nr. II0209134E Personal;

BLERËS:

Z. ROBERT ALIA, i biri i Gjovalin-it dhe Bardhe-s, lindur më 10.03.1990 në Fushë Arrëz, Pukë dhe banues në Tiranë, madhor e me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i Pasaportës, Nr. BA2641088 / Nr. J00310072S Personal,

Palët, me dëshirën dhe vullnetin e tyre të lirë, të plotë e të pavesuar, pasi kanë zhvilluar bisedime paraprake, në mbështetje të nenit 705 e vijues të Kodit Civil, Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, Ligjit Nr. 131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme Nr. 1, datë 05.06.2019, Statutin e Shoqërisë "SunTrust Broker" sh.a, ranë dakord të lidhin këtë Kontratë Shitje Aksionesh me përmbajtjen si vijon:

1. TË DHËNA PARAPRAKE

1.1 Shitësi, Z. Rigers Kasneci, është aksioner në Shoqërinë "SunTrust Broker" sh.a, shoqëri tregtare, identifikuar me Nr. NIPT (NIUS) L81421004J zotërues i **105** (njëqind e pesë) aksioneve, me vlerë nominale prej ALL 1 050 000 (një milion e pesëdhjetë mijë Lekë Shqiptare), që përfaqësojnë 30 % (tridhjetë për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

2. OBJEKTI

2.1 Nëpërmjet kësaj Kontrate, Shitësi Rigers Kasneci, i shtet palës blerëse, shtetasit Robert Alia, **105** (njëqind e pesë) aksione, me vlerë nominale prej ALL 1 050 000 (një milion e pesëdhjetë mijë Lekë Shqiptare), që përfaqësojnë 30 % (tridhjetë për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë "SunTrust Broker" sh.a, shoqëri tregtare, identifikuar me Nr. NIPT (NIUS) L81421004J.

2.2 Blerësi, Z. Robert Alia, deklaron se realizon blerjen e aksioneve të Shoqërisë "SunTrust Broker" sh.a, sipas përshkrimit të bërë në Pikën 2.1 dhe kushteve të përcaktuar në këtë Kontratë.

2.3 Transferimi i aksioneve nëpërmjet shitjes do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe më veçanërisht me dispozitat e Kodit Civil dhe Ligjit Nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar.



3. ÇMIMI DHE MËNYRA E PAGESËS

3.1 Transferimi i aksioneve të kapitalit të Shoqërisë sipas përcaktimit të bërë në nenin 2.1 të kësaj Kontrate nga Shitësi Rigers Kasneci tek Blerësi Robert Alia do të kryhet përkundrejt pagesës së çmimit prej 1 050 000 (një milion e pesëdhjetë mijë) lekë.

3.2 Palët deklarojnë së çmimi i përcaktuar në nenin 3.1 të kësaj Kontrate është paguar tërësisht nga Blerësit në momentin e nënshkrimit të këtij Akti. Palët, Shitësi dhe Blerësi nuk kanë asnjë pretendim të tashëm apo të ardhshëm për çmimin e shitjes apo mënyrës së shlyerjes së tij.

4. KALIMI I PRONËSISË

4.1 Pronësia mbi **105** (njëqind e pesë) aksione, me vlerë nominale prej ALL 1 050 000 (një milion e pesëdhjetë mijë Lekë Shqiptare), që përfaqësojnë 30 % (tridhjetë për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë "SunTrust Broker" sh.a, do të kalojë nga Shitësi tek Blerësi, në momentin e depozitimit të kësaj Kontrate në Regjistrin Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, Tiranë.

4.2 Nga momenti i depozitimit të Kontratës në Regjistrin Tregtar, Shitësi Rigers Kasneci, humbet çdo të drejtë pronësie mbi **105** (njëqind e pesë) aksione, me vlerë nominale prej ALL 1 050 000 (një milion e pesëdhjetë mijë Lekë Shqiptare), që përfaqësojnë 30 % (tridhjetë për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë "SunTrust Broker" sh.a, dhe këto të drejta fitohen nga Blerësi Robert Alia, i cili bëhet aksioner i Shoqërisë "SunTrust Broker" sh.a, me strukturën e pjesëve si vijon:

Aksionerët e Shoqërisë	Aksionet e Zotëruara	Përqindja e Kapitalit
ROBERT ALIA	210	60 %
GERJOLA ÇAUSHI	105	30 %
DHOROTHEA MALE	35	10 %
TOTALI	350 Aksione	100 %

4.3 Pala shitëse detyrohet:

- T'i kalojë palës blerëse pronësinë mbi kuotat objekt i kësaj kontrate të lirë nga çdo barrë, sekuestrim dhe detyrime të çfarëdolloj natyre.
- T'i dorëzojë palës blerëse dokumentacionin mbi pronësisë e kuotave që i shet nëpërmjet kësaj kontrate.
- Të paguajë shpenzimet e regjistrimit të kësaj kontrate në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

5. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

5.1 Për këtë Kontratë, do të jenë bazë për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve:

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë,
- Legjislacioni që rregullon organizimin dhe funksionimin e shoqërive tregtare;
- Aktet e tjera ligjore që nuk bien në kundërshtim me këtë Kontratë.

5.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të shfaqen midis palëve kontraktuese në lidhje me interpretimin, ekzekutimin, zgjidhjen apo vlefshmërinë e kësaj Kontrate, do të zgjidhen me mirëkuptim mes tyre, në rast të kundërt organi kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.



6. DISPOZITA TË FUNDIT

6.1 Administratorja i Shoqërisë "SunTrust Broker" sh.a, është e detyruar të bëjë ndryshimet përkatëse në regjistrin themeltar të aksioneve, ku Shitësi zhvishet përfundimisht nga pronësia mbi Aksionet objekt Kontrate, dhe njih pronar të ligjshëm të tyre Blerësin.


5.2 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Kontratës dhe brenda qëllimit që i bëri Palët të nënshkruajnë këtë Kontratë.

5.3 Kontrata u përpilua në 4 (katër) kopje me fuqi të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe, nga një kopje marrin Palët, një kopje depozitohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), dhe një kopje duhet të depozitohet në selinë e Shoqërisë.

Kontrata, pasi u lexua nga Palët, të vetëdijshëm se përmbajtja e saj është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë, e nënshkruajnë atë pa vese.

PALËT KONTRAKTUESE

BLERËS
ROBERT ALIA



SHITËS
RIGERS KASNECI

